

Fatmira Hajdari kërkon rikthimin në detyrë



Gjyqtarja e Apelit Tiranë Fatmira Hajdari ka apeluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit vendimin e Komisionit të Posaçëm të Vetingut për ta shkarkuar nga detyra.

Në padinë dorëzuar në KPA, Hajdari kërkon nisjen e hetimit nga e para për pasurinë, pastërtinë e figures dhe vlerësimin e saj për aftësitë profesionale.

Trupa e KPA-së që do të shqyrtojë kërkesën e Hajdarit përbëhet nga Natasha Mulaj, Albana Shtylla, Rezarta Schuetz, Ina Rama dhe Sokol Çomo.

Hajdari [u shkarkua](#) nga detyra në 18 qershor, për shkak të problemeve me pasurinë.

Vendimi u mor nga Roland Ilia, Firdes Shuli dhe Etleda Çiftja.

Fatmira Hajdari është pjesë e sistemit të drejtësisë që prej vitit 2000, fillimisht si gjyqtare në gjykatën e Tiranës.

Që prej vitit 2013, Hajdari u emërua në gjykatën e Apelit të Tiranës,
me dekret të presidentit.